



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 489 Prot.

Tiranë, më datë 01.12.2023

VENDIM
Nr. 588, datë 01.12.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.12.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks me banesa individuale 1, 2 dhe 3 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, me mure rrethuese dhe pishinë”, Mjull Bathore, Bashkia Tiranë”, hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama, me zhvillues “Anchor Investments” sh.p.k.;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren nga DRTK Tiranë sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 27/2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

